

STATUTI

i

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

BLOOM STUDIOS

08.03.2022










## PERMBAJTJA

PERMBAJTJA .....	2
TITULLI I.....	4
NENI 1: EMERTIMI, ORTAKET .....	4
NENI 2: OBJEKTI.....	4
NENI 3: QELLIMI I SHQERISE .....	5
NENI 4: TITULLI I PRONESISE.....	5
NENI 3: KOHEZGJATJA.....	6
NENI 5: SELIA.....	6
TITULLI II .....	6
KAPITALI .....	6
NENI 6: SHUMA DHE PAGESAT E KAPITALIT THEMELTAR .....	6
NENI 7: ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT .....	6
NENI 8: BLERJA E KUOTAVE NGA ORTAKET DHE TE TJERET .....	7
TITULLI III .....	7
ORGANET E SHOQERISE .....	7
NENI 9: ORGANET E SHOQERISE .....	7
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME .....	7
NENI 10: MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME .....	7
NENI 11: THIRRJA E ASAMBLESE.....	8
NENI 12: KERKESA NGA ORTAKET E PAKICES .....	9
NENI 13: PERFAQESIMI NE ASAMBLE .....	9
NENI 14: KUORUMI .....	10
NENI 15: VENDIMMARRJA NE MBLEDHJET E ASAMBLESE .....	10
ADMINISTRATORI .....	12
NENI 16: EMERIMI I ADMINISTRATORIT .....	12
NENI 17: KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT .....	12
NENI 18: LARGIMI I ADMINISTRATORIT .....	14



NENI 19: DOREHEQJA E ADMINISTRATORIT .....	14
TITULLI IV .....	15
PRISHJA DHE NJOFTIMET .....	15
NENI 20: PRISHJA E SHOQERISE .....	15
NENI 21: REGJISTRIMI I PRISHJES SE SHOQERISE .....	16
NENI 22: LIKUIDIMI I SHOQERISE .....	16
NENI 23: NJOFTIMET .....	16
NENI 24: DISPOZITA TE PERGJITHSHME .....	16
NENI 25: DISPOZITA PERFUNDIMTARE .....	16



# STATUTI

## I

### SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Bloom Studios" Sh.p.k.

Ne mbështetje të legjislacionit shqiptar, respektivisht të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, Ligjit nr. 131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", Asambleja e Ortakeve të shoqerise "Bloom Studios" Sh.p.k miraton STATUTIN i cili do të rregullojë qeverisjen e shoqerise "Bloom Studios" Sh.p.k, me dispozitat si vijon:

#### Titulli I

##### Neni 1: Emërtimi, ortaket

"Bloom Studios" Sh.p.k shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te se drejtes shqiptare, perbehet nga:

Ortaket:

- Shoqëria "FiA Holding" Sh.p.k, me NIPT M21422019K, me adresë: Rr. "Andon Zako Çajupi", pallati 20/1, shkalla 1, kati 4, ap.18 e përfaqësuar nga administratori z. Erind Neziri.
- Z. Rubin Frangu, i biri i Bujar-it, lindur në Tiranë më datë 06.10.1990, banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal J01006068J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
- Znj. Marlein Topçiu, e bija e Albert-it, e datëlindjes 13.07.1991, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal J15713079U, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Secili prej Ortakeve referohen në vijim si "Pala" dhe/ose bashkarisht si "Palet". Palet bien dakord që bashkarisht të rregullojnë qeverisjen e shoqerise "Bloom Studios" Sh.p.k (referuar në vijim si "Shoqeria") sipas këtij Statuti, si më poshtë vijon:

##### Neni 2: Objekti

- 1) Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "Bloom Studios" Sh.p.k., do të zhvillojë aktivitetet me objektin e veprimtarise si më poshte:
  - a) Shërbime Marketingu
  - b) Menaxhim rrjetesh sociale
  - c) Fotografi dhe Videografi





- d) Krijim dhe zhvillim Website
- e) Data Entry
- f) Data Science
- g) Konsulencë marketingu
- h) Krijim dhe Zhvillim i fushatave të marketingut
- i) Design dhe Brandizim
- j) Perveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari që do të konsiderohet nga ortakët si e nevojshme dhe e pershtatshme për arritjen e objektivit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin Shqiptar.

### Neni 3: Qellimi i Shoqërisë

1. Qellimet e Shoqërisë janë të:
  - a) angazhohet në Biznes;
  - b) të mbaje dhe përdorë pasuritë e Shoqërisë në lidhje me operimin dhe kryerjen e Biznesit; dhe
  - c) të angazhohet në secilin dhe në çdo aktivitet dhe transaksion të nevojshëm ose të pershtatshëm për të operuar dhe kryer Biznesin.
2. Shoqëria do të ketë të gjitha kompetencat e nevojshme në mënyrë të arsyeshme, të duhura ose të pershtatshme për zhvillimin e Biznesit në përputhje me, dhe sipas termave dhe kushteve të këtij Statuti.

### Neni 4: Titulli i Pronësive

1. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Statut ose ndonjë Marrëveshje tjetër në të cilën bëhet Pakti Shoqëria:
  - a) Të gjithë asetet dhe pasuritë, qofshin ato reale, personale ose të perziera, të luajtshme ose të paluajtshme, përfshirë të drejtat kontraktuale, të zotëruara ose në përdorim nga Shoqëria do të mbahen ose përdoren në emër të Shoqërisë.
  - b) Të gjithë asetet, pasuritë dhe të drejtat do të konsiderohen se zotërohen ose posedohen nga Shoqëria si një entitet i pavarur juridik.
  - c) Shoqëria do të ketë të drejtën të formojë dhe të mbaje interesa, në mënyrë direkte ose indirekte, në një ose më shumë shoqëri, partneritete ose entitete të tjera me qëllim për të zotëruar asetet e Shoqërisë ose operimin e të gjithë ose një pjesë të Biznesit.

### Neni 3: Kohezgjatja

1. Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise Tregtare "Bloom Studios" Sh.p.k. eshte deri me 03.02.2028. Ajo mund te shperbehet ne cdo moment, sipas vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve.

### Neni 5: Selia

1. Selia e Shoqerise Tregtare "Bloom Studios" Sh.p.k. eshte Rr. "Andon Zako Cajupi", Pallati 20/1, Shkalla 1, Kati 4, Ap 18, Tiranë.
2. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashte saj. Per kete, ajo mund te hape edhe seli te tjera operative, filiale, perfaqesi dhe agjenci ne te gjithë territorin e Republikën e Shqipërisë, si dhe jashte saj, ne perputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

### Titulli II

### Kapitali

### Neni 6: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar

1. Kapitali themeltar i kesaj Shoqerie me Pergjegjesi te kufizuar "Bloom Studios" Sh.p.k është 100.000 (njëqind mijë) Lekë. Kontributi i ortakeve ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:
  - Shoqëria "FiA Holding" Sh.p.k, me NIPT M21422019K, e përfaqësuar nga administratori z. Erind Neziri, zotërues i 1(një) kuote me vlerë 70.000 (shtatëdhjetë mijë) Lekë, që përbën 70% të kapitalit të shoqërisë.
  - Znj. Marlein Topçiu, e bija e Albert-it, e datëlindjes 13.07.1991, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal J15713079U, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, zotëruese e 1(një) kuote me vlerë 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) Lekë që përbën 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.
  - Z. Rubin Frangu, i biri i Bujar-it, lindur në Tiranë më datë 06.10.1990, i identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal J01006068J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, zotërues i 1(një) kuote me vlerë 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) Lekë, që përbën 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

### Neni 7: Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit

1. Asambleja e Pergjithshme mund ta zmadhoje kapitalin, me vendim te kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues me shumatat qe percaktohen ne vendimin e marre prej saj. Ne kete rast, vendimi duhet gjithmone te merret me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne te pakten 75% (shtatedhjetepese perqind) te kapitalit. Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar, te gjithë ortakët do te kene te drejte te nenshkruajne zmadhimin e tij ne proporcion me pjeset e tyre ne



kapital. I njeiti vendim i kualifikuar kerkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u jape mundesi ortakeve te rinj te hyjne ne shoqeri.

2. Me ane te nje vendimi te kualifikuar, shoqeria mund ta zvogeloje kapitalin e vet. Ne kete rast, vendimi duhet gjithmone te merret me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne te pakten 75% (*shtatedhjetepese perqind*) te kapitalit. Ne rast zvogelimi te kapitalit themeltar, te gjitha ortaket do te kene te drejte te nenshkruajne zvogelimin e tij ne proporcion me pjeset e tyre ne kapital. Ne çdo rast, kapitali i shoqerise nuk mund te zvogelohet nen kufirin e parashikuar me ligj.

#### **Neni 8: Blerja e Kuotave nga Ortaket dhe te Tjeret**

1. Ortaket e shoqerise kane perparesi per blerjen e pjeses qe shitet perpara personave te trete jashte shoqerise. Ortaku qe deshiron te transferoje ose te shese kuotat e tij i drejton nje kerkese me shkrim asamblese, duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet edhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e bleresit. Ortaku jep oferten brenda 60 (*gjashtedhjete*) diteve nga data e njoftimit dhe duhet t'u transmetoje ortakeve te tjere kete kerkese dhe ortaket e tjere duhet te japin nje pergjigje brenda 60 diteve. Edhe e drejta e perparemise, duhet t'u jepet me shkrim duke iu drejtuar asamblese.
2. E drejta e perparemise eshte proporcionale me kuotat e secilit prej ortakeve, por nese nje ortak nuk eshte i interesuar, tjetri mund t'i bleje kuotat qe shiten.
3. Asambleja pasi ka kaluar afati prej 60 (*gjashtedhjete*) diteve, brenda 30 (*tridhjete*) diteve i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij, vendimin e ortakeve te tjere per te blere te gjitha ose pjeserisht kuotat e tij. Ne rast se kuotat nuk shiten brenda shoqerise, atehere keto kuota brenda 60 (*gjashtedhjete*) diteve i ofrohen personave te trete jashte shoqerise. Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet te behet me akte noteriale dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e ortakeve.

### **TITULLI III**

#### **Organet e Shoqerise**

#### **Neni 9: Organet e Shoqerise**

1. Organet e Shoqerise jane:
  - a) Asambleja e Pergjithshme;
  - b) Administratori/et;

#### **Asambleja e Pergjithshme**

#### **Neni 10: Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme**

1. Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, nga ligje te tjera te lidhur me te ose nga

dispozitat e Statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

2. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.
3. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket te ciler kane ne zoterim me pak se 5% e kuotave.
4. Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se **5% (pesë perqind)** te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
5. Asambleja e pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
6. Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% (pesë perqind) te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
7. Ne rast te pikave 5 dhe 6, asamblese se pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.
8. Dispozitat e pikes 7 te ketij neni nuk zbatohen nese blerjet, sipas pikave 5 e 6 te ketij neni, kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perditshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu.
9. Ne rastet e parashikuara ne pikat 5 deri ne 6 te ketij neni, asambleja e pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve

#### Neni 11: Thirrja e Asamblese

1. Mbledhja e Asamblese se zakonshme thirret te pakten nje here ne vit.
2. Administratori mund te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme kur ai e mendon se eshte e arsyeshme dhe duhet te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme sa here ta kerkojne ortaket ne perputhje me parashikimet ligjore.
3. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites i cili duhet t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se **7 dite** perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
4. Afati i parashikuar ne piken 3 te ketij neni, mund te jete edhe me i shkurter nese kete e aprovojne shumica e ortakeve qe zoterojne jo me pak se pesedhete perqind te vleres nominale te kuotave.
5. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas menyres se parashikuar nga ky nen, ajo









mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket japin miratimin, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise. Ky miratim, duhet te jete e shprehur qartesisht ne vendimin qe do te dale ne perfundim te mbledhjes.

### Neni 12: Kerkesa nga Ortaket e Pakices

1. Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise, mund t'i drejtojne administratoreve nje kerkese me poste elektronike, per te thirrur asamblene e pergjithshme dhe/ose perfshirjen e çeshtjeve te posaçme ne rendin e dites. Kerkesa duhet te permbaje arsyet, objektivat dhe çeshtjet, per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim. Nese kerkesa refuzohet, keta ortake kane te drejte ta therrasin asamblene dhe te caktojne çeshtjet e rendit te dites, ne perputhje me nenin **Thirrja e Asamblese**.
2. Nese, ne kundërshtim me piken 1 te ketij neni, asambleja e pergjithshme nuk thirret, ose çeshtja e kerkuar prej ketyre nuk futet ne rendin e dites, secili prej ortakeve, qe kane bere kerkesen, ka te drejte:
  - a) te ngreje padi ne gjykate, per te deklaruar shkeljen e detyrimit te besnikerise, nese administratoret nuk permbushin kerkesat e ortakeve brenda 15 diteve;
  - b) t'i kerkoje shoqerise blerjen e kuotave, te zoteruara prej tyre.
3. Ne rastet kur rendi i dites ndryshohet, sipas parashikimeve te ketij neni dhe thirrja i eshte njoftuar ortakeve, administratoret njoftojne perseri rendin e dites, te ndryshuar, ne perputhje me parashikimet e nenit **Thirrja e Asamblese**.

### Neni 13: Perfaqesimi ne Asamble

1. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë.
2. Administratoret e shoqerise **nuk** mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
3. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite. Perjashtim, behet ne rastin e prokures se posaçme, e cila mund te behet me per perfaqesim ne me shume se nje mbledhje.
4. Perfaqesuesi i autorizuar eshte i detyruar te deklarroje çdo fakt apo rrethane, te tille qe, sipas gjykimit te ortakut te perfaqesuar, rrezikon te ndikojë ne vendimmarrjen e perfaqesuesit per interesa te tjere te ndryshem nga ata te ortakut te perfaqesuar

*Ufopainu*

#### Neni 14: Kuorumi

1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.
2. Pjesemarrja ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme mund te jete me pjesemarrje fizike nga vete personi, me perfaqesim sipas nenit **Perfaqesimi ne Asamble**. Apo edhe permes mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen, qofte kjo permes lidhjes me audio ose permes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88 te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar.
3. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne **75%** te votave.
4. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur ne piken 1 te ketij neni, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### Neni 15: Vendimmarrja ne Mbledhjet e Asamblese

1. Asambleja e Pergjithshme e ortakeve merr vendime me shumice te zakonshme per ceshtjet ne vijim:
  - a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise te cilat prekin mbi 50% te aseteve te shoqerise
  - b) emerimin dhe shkarkimin e administratorit
  - c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
  - d) emertimin dhe shkarkimin e audituesit te pavarur;
  - e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "b" dhe "c" te ketij neni;
  - f) investime te cilat jane pertej aktivitetit te zakonshem dhe/ose te perditshem te shoqerise
2. Asambleja e pergjithshme e ortakeve shqyrton dhe merr vendime, kuorumin e ortakeve qe perfaqesojne te pakten 75% (shtatedhete e pese perqind) te kuotave, per ceshtjet ne vijim:
  - a) ndryshimet e statutit;
  - b) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - d) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
  - e) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - g) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
  - h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
  - i) shperndarjen e fitimeve;





- j) tjetersimi i asetëve të shoqërisë
  - k) ndryshimi i formës ligjore të Shoqërisë;
  - l) shpërndarja e dividendëve;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo nënë specifike të këtij Statuti;
3. Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotuesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit nr. Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
  4. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmeria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës
  5. Asambleja e përgjithshme e ortakëve shkarkon administratorin me shumicë të zakonshme votash.
  6. Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
  7. Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblese së Përgjithshme.
  8. Me pëlqimin e mbledhjes në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblese, por në një mbledhje të shtyre të Asamblese nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyre punimet e Asamblese. Kur punimet e Asamblese janë shtyre për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plotë në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyre dhe natyra e përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.
  9. Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblese merren me vote të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë: 1. Kryetari; ose 2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se 5% (pese përqind) të votave gjithsej të asamblese së shoqërisë. Kërkesa e bëret nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak ka të njëjten vlerë sikur ta bëjë ortakë në fjalë.
  10. Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit, se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
  11. Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.





## Administratori

### Neni 16: Emerimi i Administratorit

1. Asambleja e Pergjithshme emerone nje person si administrator te vetem te shoqerise sipas Nenit 95 te Ligjit. Emerimet i nenshtrohen individualisht nje vendimi me voten pro te shumices se zakonshme, te kapitalit themelues, nese miratohet, çon ne zgjedhjen e personit te propozuar si administrator.
2. Shoqeria do te drejtohet nga Administratori z. Rubin Frangu, i biri i Bujar-it, lindur në Tiranë më datë 06.10.1990, i identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal J01006068J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i cili do te kete nje mandat administratori 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
3. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme.
4. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

### Neni 17: Kompetencat e Administratorit

1. Veprimtaria tregtare e shoqerise menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtroje te gjitha kompetencat e shoqerise qe nuk i jane rezervuar Asamblese se Pergjithshme. Administratori ka keto te drejta dhe detyrime:
  - a. te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise;
  - b. te perfaqesoje shoqerine tregtare perballe paleve te treta si dhe ne te hyje ne marredhenie kontraktore me te tretet si perfaqesues i shoqerise;
  - c. te perfaqesoje shoqerine, ne menyre aktive ose pasive, perpara çdo autoriteti gjyqesor, administrativ, fiskal, ne çdo procedure, ne çdo shkalle te gjykimit, si ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj, me te drejten per te nenshkruar çdo akt ose dokument te nevojshem sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet perkatese, pra, edhe me leshimin e prokurave, mandateve te veçanta per avokate, mbrojtës, te pergjithshme dhe per mosmarreveshje; te leshojne ose te revokojne mandate *ad lites* avokateve dhe mbrojtësve dhe *ad negotia* punonjesve te shoqerise ose te treteve per nje ose me shume veprime, ne kuader te kompetencave perkatese;
  - d. te çele llogari rrjedhese bankare, te kryeje depozitime dhe terheqje parash pa limit vlere
  - e. kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise
  - f. te punesoje, te pezulloje, te largoje nga puna dhe te ndryshoje kushtet qe lidhen me marredhenien e punes se personelit;



- g. te nderveproje me Entet e Administrates Publike per çdo negociim qe lidhet me oferta, projekte, pjesemarrje, gjithnje brenda kufijve te parashikuar nga objekti i shoqerise;
- h. te leshoje ekstrakte te borderove dhe vertetime qe lidhen me personelin, si per entet e sigurimeve shoqerore, ashtu dhe per ente te tjera ose private; te kujdeset per respektimin e permbushjeve, ndaj te cilave shoqeria eshte e detyruar, me te drejten per te nenshkruar deklarata tatimore, qe kane lidhje me mbajtjet nga te ardhurat e punes se varur ose autonome qe jane perdorur;
- i. pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- j. te nenshkruaje deklarata fiskale ne lidhje me taksat dhe tatimet ne pergjithesi, si dhe çdo akt ose çertifikate te parashikuar nga legjislacioni fiskal ne fuqi, te kerkoje rimbursime dhe lehtesime nga taksat dhe tatimet, te perfaqesoje shoqerine perpara organeve te administrates fiskale dhe prane komisioneve tatimore te çdo shkalle, me te drejten per te emeruar mbrojtes te posaçem;
- k. krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- l. te perfaqesoje shoqerine prane organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qellim fitimin e konçesioneve, liçencave dhe lejeve, duke emeruar, nese eshte e nevojshme edhe mbrojtes te posaçem;
- m. te nenshkruaje autorizimet e bankes mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit ne llogari rrjedhese dhe ekstrakteve periodike te llogarive rrjedhese per vartesis e shoqerise per shumat e depozituara prane saj;
- n. te nenshkruaje kontrata investimi, sherbimi, shitblerje te mallrave etj, ne kufijte e objektit te shoqerise
- o. raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare
- p. te kryeje çdo formalitet per firmosjen e nje akti dhe/ose dokumenti me qellim depozitimin e akteve dhe dokumenteve te shoqerise prane Gjykates, Dhomes se Tregtise, Zyrave Fiskale dhe Enteve te tjera;
- q. te perfaqesoje shoqerine ne asamblete e shoqerive te tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe ne marredheniet me keto ente, organet e tyre dhe ortaket ose te asociuarit e tyre, dhe te emeruje perfaqesues, te delegoje me mandat dhe/ose prokure, aq sa i takon kompetencave te tij.



- r. kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit
  - s. kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne kete Statut
2. Administratori mund t'ia delegoje kompetencat e tij komiteteve qe perbehen nga nje ose me shume anetare. Nje delegim i tille mund te behet ne varesi te kushteve qe mund te vendose Administratori dhe mund te revokohet ose te ndryshohet.
  3. Asnje ndryshim i Statutit dhe asnje direktive nga ana e Asamblese se Pergjithshme nuk mund t'i beje te pavlefshme veprimet e meparshme te Administratorit, te cilat do te kishin qene te vlefshme, nese nuk do te ishte bere ndryshimi apo nese nuk do te ishin dhene direktiva.

#### **Neni 18: Largimi i Administratorit**

1. Posti i Administratorit lirohet nese:
  - a) Shkarkohet me Vendim Asambleje;
  - b) Vuan nga paaftesi fizike ose mendore te cilat e pengojne te kryeje veprimtarine;
  - c) Jep doreheqjen permes nje njoftimi qe i ben shoqerise;
  - d) Ka munguar per me shume se tre muaj radhazi pa leje ne aktivitetin e perditshem te shoqerise dhe asambleja e pergjithshme, me propozim te ortakeve te tjere vendos ta liroje nga detyra.

#### **Neni 19: Doreheqja e Administratorit**

1. Administratori mund te heqe dore ne cdo kohe nga detyra e tij, nepermjet nje njoftimi me shkrim drejtuar asamblese se pergjithshme. Administratori, qe jep doreheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarise se shoqerise, eshte gjithashtu i detyruar te therrase asamblene e pergjithshme per emerimin e administratorit te ri, perpara dates ne te cilen doreheqja te hyje ne fuqi.
2. Nese asambleja e pergjithshme nuk vendos emerimin e administratorit te ri ne daten e percaktuar ne thirrjen e kryer nga administratori i dorehequr, atehere administratori i njofton me shkrim doreheqjen Qendres Kombetare te Biznesit, se bashku me kopjen e thirrjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme dhe Qendra Kombetare e Biznesit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Biznesit", te ndryshuar.
3. Doreheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkelje te detyrimit te besnikerise qe administratori ka ndaj saj, sipas ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".





**Titulli IV**  
**Prishja dhe Njoftimet**  
**Neni 20: Prishja e Shoqerise**

1. Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet:
  - a) Kur mbaron kohezgjatja, per te cilen eshte themeluar;
  - b) Me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
  - c) Ne rast se objekti behet i perealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare;
  - d) Ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise, te parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. Nr.9901, date 14.4.2008 "Per Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare";
  - e) Ne raste te tjera, te parashikuara me ligj;
  - f) Per cdo shkak tjetër te vendosur nga asambleja e ortakeve
2. Prishja e shoqerise, si pasoje e nje apo me shume prej shkaqeve te percaktuara ne shkronjat "a", "c", "e", dhe "f", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga asambleja me shumice te kualifikuar, pra 75% e votave.
3. Ne rast mosveprimi te asamblese se ortakeve per te vendosur prishjen, per shkaqet e percaktuara ne shkronjat "a", "c", "e", dhe "f", te pikes 1, te ketij neni, cdo person i interesuar mund, ne cdo kohe, t'i drejtohet gjykates per te konstatuar prishjen shoqerise.
4. Pavaresisht nga parashikimet e siperpermendura, ekzistenca e nje a me shume shkaqeve, te parashikuara nga shkronjat "a", "c", e, dhe "f", te pikes 1, te ketij neni, nuk do te kete si pasoje prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nese perpara vendimit gjyqesor te formes se prere, te permendur ne piken 3, te ketij neni, shkak i prishjes eshte korrigjuar, nese eshte e mundshme te korrigjohet, dhe ky korrigjim eshte publikuar nga shoqeria ne regjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjit 131/2015, "Per Qendren Kombetare te Biznesit", te ndryshuar.
5. Prishja e shoqerise, si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "b", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentimit, kur, ne perfundim te ketyre procedurave, te gjitha pasurite e shoqerise jane likuiduar per shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendos rrezimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se shoqerise per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.



6. Prishja e shoqerise si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "c", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve te nenit 3/1 te Ligjit 9901, date 14.04.2008 "*Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare*" i ndryshuar.

#### Neni 21: Regjistrimi i Prishjes se Shoqerise

1. Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, ne perputhje me nenin 43 te ligjit 131/2015, "*Per Qendren Kombetare te Biznesit*", te ndryshuar. Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te ligjit nr. 131/2015, "*Per Qendren Kombetare te Biznesit*", te ndryshuar ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Biznesit per regjistrim

#### Neni 22: Likuidimi i Shoqerise

1. Me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi, prishja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, sipas Ligjit per tregtaret dhe shoqerite tregtare.
2. Ne rast te likuidimit te shoqerise, likuiduesit me autoritetin qe i jep nje vendim i kualifikuar i Asamblese se Pergjithshme dhe ne perputhje me Ligjit 9901, date 14.04.2008 "*Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare*" i ndryshuar, mund t'i shperndaje ortakeve te gjithe vleren ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim mund t'i vleresoje pasurite dhe te percaktoje se si te behet nje shperndarje e tille midis ortakeve.

#### Neni 23: Njoftimet

1. Njoftimet dhe komunikimet per njoftime mes personave te shoqerise, do te kryhen nepermjet postes elektronike ne adresen qe eshte e vlefshme per momentin dhe i eshte bere e ditur shoqerise nga ana e ortakut.
2. Perjashtim nga paragrafi i mesiper, bejne rastet kur shperihimish ne kete Statut dhe ne ligj parashikohet si forme e vetme e lejuar, komunikimi me shkrese.

#### Neni 24: Dispozita te Pergjithshme

1. Per sa i perket ceshtjeve qe nuk jane parashikuar nga ky statut, do te aplikohen dispozitat e Shoqerive me Pergjegjesi te kufizuar sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008 "*Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare*" i ndryshuar.
2. Çdo mosmarreveshje qe del nga kjo marreveshje do te caktohet para gjykates se vendit, ku ndodhet zyra e regjistruar e shoqerise.

#### Neni 25: Dispozita Perfundimtare

1. Ky Statut perpilohet ne 2 (dy) ekzemplare origjinale, me vlere te njejte ligjore, ne gjuhen shqipe.



2. Ky Statut do te hyje ne fuqi menjehere me nenshkrimin e tij.

Lexuar, miratuar dhe nenshkruar.

ORTAKET E SHOQERISE TREGTARE

Znj. Marlein Topçiu

*Marlein Topçiu*  
*ufopçiu*

Z. Rubin Frangu



Shoqëria "FiA Holding" Sh.p.k

Administrator

z. Erind Neziri

*Erind Neziri*  


**FiA HOLDING**  
**N21422019K**